

MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 13/ 11 / 2024, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në mbështetje të Nenit 75 pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se: *“Autoriteti ose Enti Kontraktor nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për cfarëdo lloj arsyeje me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”*. Për procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndertimi i ures mbi perroin ne lagjen Celaj, Toç”**, për shkak të një lapsusi, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse, si më poshtë vijon:

Ishte:

- 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**
- **NP-1 B**
- **NP4-D**

Bëhet:

- 2.3.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

NP–1 Punime gërmimi në tokë.

NP–4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

NP–12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Afati kohor për dorëzimin e ofertave mbetet i pandryshuar.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 21/ 11 / 2024 Ora: 10 : 00

Vendi: www.app.gov.al, Bashkia Memaliaj